



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 2372/1 prot.

Tiranë, më 26.09.2025

Lënda: Jepet mendimi mbi një projektvendim

MINISTRISË SË BRENDASHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 4808/2 prot., datë 17.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2372 prot., datë 19.09.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “*Për miratimin e rregullores së përpunimit të informacionit të udhëtimit*”, si dhe relacionin shoqërues.

Pas shqyrtimit të tekstit të projektvendimit dhe të relacionit shoqërues, konstatohet se ky akt synon të vendosë një kuadër të qartë dhe të detajuar rregullash mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes dhe përdorimit të informacionit të udhëtimit.

Përmes dispozitave të propozuara, theksohet rëndësia e parimeve të proporcionalitetit, transparencës dhe sigurisë gjatë trajtimit të të dhënave, si dhe përcaktohen përgjegjësitë konkrete të autoriteteve kompetente dhe subjekteve të tjera që administrojnë informacionin e udhëtimit. Në të njëjtën kohë, parashikohet edhe roli aktiv i Zyrës së Komisionerit si autoritet mbikëqyrës, i cili në bazë të kompetencave të tij ligjore, do të ketë mundësi të ushtrojë funksione monitoruese, këshilluese dhe ndërhyrëse, me qëllim garantimin e respektimit të standardeve ligjore dhe të drejtave themelore të qytetarëve.

Pas analizimit të tekstit të projektvendimit “*Për miratimin e rregullores së përpunimit të informacionit të udhëtimit*”, në kuadër të harmonizimit të kuadrit rregullator si dhe zbatimit të parimeve dhe kriterëve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, nga ana jonë janë hartuar disa sugjerime dhe komente si më poshtë vijon:

Në pikën 4, të nenit 12, dhe në shkronjën “dh” të nenit 14 të draftit sugjerojmë që në zbatim të ligjit nr. 124/2024 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” (në vijim “Ligji”) dhe në kuadër të përputhshmërisë së terminologjisë së përcaktuar në këtë projektvendim me Ligjin, togfjalëshi “*nëpunësi/it e ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave*” të zëvendësohet me togfjalëshin “*nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave*” sipas parashikimeve të nenit 33 të Ligjit.

Referuar pikës 4, të nenit 17 të Ligjit ku përcaktohet se “*Rezultati i përpunimit të të dhënave të udhëtimit për rastet pozitive do të mbahet nga SIU, për aq kohë sa është e nevojshme për të informuar autoritetet kompetente apo agjencitë ndërkombëtare të zbatimit të ligjit, me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje bashkëpunimi*”, sugjerojmë përcaktimin e një afati të arsyeshëm për përpunimin e të dhënave personale për rastet pozitive në përputhje me parimin e kufizimit të ruajtjes në kohë të të dhënave personale, në zbatim të pikës 5, të nenit 6, të Ligjit.

Sa i përket pikës 1, të nenit 22, sugjerojmë që togfjalëshi “*shkëmbimi ose komunikimi i të dhënave personale ...*” të zëvendësohet me fjalën “përpunim” me qëllim harmonizimin e terminologjisë së përcaktuar në Ligj. Në këtë kuadër, përpunimi përfshin çdo veprim ose një grup veprimesh, që kryhet mbi të dhënat personale ose grupe të dhënash personale, të tilla, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, përhapja me anë të transmetimit, shpërndarjes ose vënies në dispozicion në ndonjë mënyrë tjetër, lidhja ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi.

Në vijim, në pikën 1 të nenit 23, togfjalëshi “*të dhënat e udhëtimit*” të zëvendësohet me togfjalëshin “*të dhënat e pasagjerit*”, për shkak të logjikës së përpunimit të të dhënave personale, duke qenë se termi “*udhëtim*” përfshin edhe të dhëna të tjera të cilat janë jashtë fushës së veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit.

Në nenin 24 të projektvendimit sugjerojmë që titulli i këtij neni të riformulohet: “***Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave***”. Gjithashtu sugjerojmë që po në këtë nen të shtohet një pikë e veçantë me përmbajtje si vijon: “*Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave merr pjesë në aktivitetet e vlerësimit të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave*”.

Referuar pikës 3 të nenit 29, me përmbajtje: “*Mbikëqyrja bëhet vetëm në kontrollin e gjurmëve të transmetimit të informacionit, pa u njohur me përmbajtjen e tij*”, vërejmë se kjo dispozitë kufizon veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit në ushtrimin e funksioneve të përcaktuara me ligj, duke mos i dhënë mundësinë për tu njohur në mënyrë të plotë me informacionin edhe në rastet kur ai përmban të dhëna personale. Ky parashikim bie në kundërshtim me nenin 84 të Ligjit. Në këtë kuadër sugjerojmë heqjen e kësaj pike nga projektvendimi.

Zyra e Komisionerit sugjeron që në këtë projektvendim të shtohet një nen më vete me titull “*Ruajtja e konfidencialitetit*” dhe përmbajtje si vijon: “*Çdo punonjës që përpunon*

të dhëna të pasagjerit apo vihet në dijeni të tyre, nuk mund të bëjë të njohur përmbajtjen e këtyre të dhënave, personave të tjerë të paautorizuar. Ata detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë, edhe pas përfundimit të funksionit/detyrës.

Çdo punonjës i Sektorit të Inteligjencës së Udhëtimit, me përfundimin e detyrës në këtë njësi, ka për detyrë të nënshkruajë deklaratën përkatëse, me anë të së cilës merr përsipër mosekspozimin e informacionit, me të cilin është njohur për shkaqe të ushtrimit të detyrës funksionale.”

Me reflektimin e sa më sipër, Zyra e Komisionerit e vlerëson projektvendimin, të hartuar konform legjislacionit për të drejtën e informimit dhe legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale shprehet dakord për miratimin e saj.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi